

UDHËZIM I PËRBASHKËT

Nr. 196, datë 11.4.2023

PËR MIRATIMIN E KRITEREVE TË VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE PËR DREJTUES TË SHËRBIMIT NË STRUKTURAT SHËNDETËSORE UNIVERSITARE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në pikën 10, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 424, datë 10.5.2017, “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurës së përzgjedhjes e të emërimit të drejtuesve të shërbimit në strukturat shëndetësore universitare”, të ndryshuar,

UDHËZOJMË:

1. Miratimin e kriterëve të vlerësimit të kandidatëve për drejtues të shërbimit në strukturat shëndetësore universitare si vijon:

Nr.	Kriteret vlerësuese	Pikëzimi
1	Të zotërojnë titullin/gradën	
	Profesor	15 pikë
	Profesor i asociuar	10 pikë
	PHD	5 pikë
	Doktoraturë	3 pikë
2	Projekti 4-vjeçar i kandidatit për zhvillimin e shërbimit shëndetësor ku aplikon	53 pikë
3	Aftësi profesionale dhe organizative në strukturat shëndetësore	14 pikë

2. Udhëzimi i përbashkët nr. 644, datë 11.9.2018, “Për miratimin e kriterëve të vlerësimit të kandidatëve për drejtues të shërbimit në strukturat shëndetësore universitare”, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
Evis Kushi